RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË MINISTRINË E ARSIMIT



Tiranë, korrik 2026

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3**
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**3**
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	**3**
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	**4**
II	**HYRJA**	**4**
1.	Objektivat dhe qëllimi	**5**
2.	Identifikimi i çështjeve	**5**
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	**5**
4.	Përgjegjësitë e audituesve	**6**
5.	Kriteret e vlerësimit	**6**
6.	Standardet e auditimit	**6**
7.	Metodat e auditimit	**7**
8.	Dokumentimi i auditimit	**7**
I!I.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**7**
1.	**Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**	**7**
2.	**Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**	**8**
2.1.	Auditimi i Qeverisjes dhe sigurisë së informacionit	**8**
2.2	Auditimi i Sistemeve	**13**
IV.	**REKOMANDIME**	**13**

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", datë 27.11.2014, zhvilloi një auditim të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Arsimit (MA) nga data 11.03.2026 deri më datë 30.04.2026.
Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.
Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

a. Përshkrim i shkurtër i Institucionit:

Ministria e Arsimit është autoriteti më i lartë ekzekutiv i menaxhimit të arsimit para universitar, e cila ka për mision zbatimin e politikave kombëtare arsimore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë qytetarët shqiptarë. MA harton dhe ndjek zbatimin e strategjive kombëtare arsimore, bazës ligjore për arsimin, nxjerrjen e akteve nënligjore, planifikon buxhetin, si dhe bashkëpunon me njësitë themelore të qeverisjes lokale, si edhe përcakton standardet e kurrikulës, administrative dhe infrastrukturore dhe harton politikat e zhvillimit profesional.

b. Rëndësia e Institucionit dhe e auditimit të tij

Ministria e Arsimit ka një rol të rëndësishëm në administrimin dhe zhvillimin e politikave publike në fushën e arsimit, duke kontribuar në realizimin e objektivave strategjikë dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Përmbushja efektive e funksioneve të tij mbështetet gjithnjë e më shumë në përdorimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, të cilat mundësojnë administrimin, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për veprimtarinë institucionale.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i mënyrës së qeverisjes, menaxhimit dhe kontrollit të burimeve të Teknologjisë së Informacionit, me synim identifikimin nëse strukturat, proceset, politikat dhe masat e kontrollit të vendosura sigurojnë përdorimin efektiv, të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemeve të informacionit në mbështetje të objektivave institucionale.
Auditimi është kryer për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2025, duke u fokusuar në drejtimin e auditimit "Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit". Në kuadër të këtij drejtimi është vlerësuar nëse institucioni ka krijuar dhe zbatuar një kuadër të përshtatshëm qeverisjeje për Teknologjinë e Informacionit, i cili siguron përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive, planifikimin strategjik të TI-së, menaxhimin e burimeve teknologjike, administrimin e risqeve, zbatimin e politikave dhe procedurave, si dhe monitorimin e performancës së funksioneve të Teknologjisë së Informacionit.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Në realizimin e auditimit është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku, duke u fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e fushave me rëndësi dhe ekspozim më të lartë ndaj risqeve të Teknologjisë së Informacionit. Qasja audituese është mbështetur në metodologjinë e KLSH-së për auditimin e bazuar në risk, e cila synon përdorimin efektiv dhe eficient të burimeve të auditimit, duke orientuar procedurat audituese drejt proceseve, kontrolleve dhe aktiviteteve që paraqesin ndikim më të madh në arritjen e objektivave institucionale.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në raportin e auditimit janë formuluar 9 gjetje dhe 9 rekomandime për masa organizative

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

Nga verifikimi i dokumentacionit teknik rezultoi se Ministria e Arsimit nuk ka kërkuar dhe administruar në mënyrë periodike raporte nga institucionet e varësisë (institucionet që administrojnë sisteme) lidhur me veprimtarinë e sistemeve informatike që këto struktura administrojnë, përfshirë performancën, disponueshmërinë, incidentet teknike, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe realizimin e objektivave përkatëse. Mungesa e kërkesës dhe administrimit të këtyre raporteve kufizon monitorimin institucional, vlerësimin e eficiencës së sistemeve dhe marrjen e vendimeve të mbështetura në informacion të plotë mbi funksionimin e tyre. Kjo praktikë vjen në mospërputhje me praktikat e mira të qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit dhe kërkesat e kuadrit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut në sektorin publik (përfshirë parimet e COBIT).
- Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025, nuk ka planifikuar dhe nuk ka kryer auditime në fushën e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 8 dhe 14 të Ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik". Mungesa e auditimeve të TI-së kufizon vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve të përgjithshme dhe specifike të teknologjisë së informacionit, si dhe mundësinë për identifikimin dhe adresimin në kohë të dobësive që lidhen me sigurinë e informacionit, administrimin e sistemeve, menaxhimin e rreziqeve dhe vazhdimësinë e shërbimeve.
- Nga verifikimi i pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit të Ministrisë së Arsimit rezultoi se disa prej tyre kanë përfunduar ciklin e jetës (EOL), konkretisht serveri Dell EMC PowerEdge R640, *storage* Dell EMC PowerVault ME4024 dhe pajisja e sigurisë Sophos XG430. Këto pajisje paraqesin risk për vazhdimësinë e shërbimeve dhe sigurinë, për shkak të mundësisë së mungesës së mbështetjes teknike. Kjo situatë është në kundërshtim me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022 për menaxhimin e aseteve teknologjike dhe me praktikat e mira të qeverisjes së TI-së.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

- Ministria e Arsimit të marrë masa duke vendosur një mekanizëm të rregullt raportimi nga institucionet e varësisë për sistemet që ato administrojnë, ku të kërkohen raporte periodike mbi performancën, disponueshmërinë, incidentet teknike, mirëmbajtjen dhe realizimin e objektivave, si dhe të krijojë një proces të qartë për analizimin dhe ndjekjen e këtyre raporteve.
- Ministria e Arsimit nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa mbi planifikimin dhe kryerjen e auditimeve mbi teknologjinë e informacionit, me qëllim vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e TI-së, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive mbi arritjen e objektivave të institucionit.
- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e TI-së të atashuar nga AKSHI, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një plani për modernizimin e pajisjeve që kanë arritur fundin e ciklit të jetës, duke përcaktuar prioritetet, buxhetin dhe afatet për zëvendësimin e serverëve, sistemeve të ruajtjes së të dhënave (storage) dhe pajisjeve të sigurisë, me qëllim minimizimin e riskut për vazhdimësinë e shërbimeve dhe sigurinë e infrastrukturës së TI-së.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimet në sektorin publik, ISSAI 5300 - Udhëzime për

auditimin e IT-së dhe ISSAI 5310 - Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*". Nga auditimi i kryer, është evidentuar se në Ministrinë e Arsimit funksionimi i teknologjisë së informacionit mbështetet në një model të centralizuar administrimi nga AKSHI, por pa u shoqëruar me mekanizma të mjaftueshëm institucionalë për qeverisje, monitorim dhe llogaridhënie në nivel të Ministrisë. U evidentuan mangësi në përditësimin e kuadrit të brendshëm rregullator, mungesë e formalizimit të marrëdhënieve me AKSHI-n. Në tërësi, këto mangësi tregojnë se, ndonëse administrimi teknik i sistemeve është i centralizuar, Ministria nuk ka ndërtuar mekanizma të plotë kontrolli dhe mbikëqyrjeje për të garantuar sigurinë, vazhdimësinë, integritetin dhe efektivitetin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit që mbështesin veprimtarinë e saj dhe të institucioneve në varësi.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1210/1, datë 12.03.2026., të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 12.03.2026 deri në 30.04.2026, në Ministrinë e Arsimit, (më poshtë MA), ku periudha e audituar është 01.01.2024 deri në 31.12.2025, u krye auditimi me objekt "*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*", nga audituesit:

1. R.A, përgjegjës grupi
2. A.A anëtar
3. J.K, anëtar

II.1. Objektivat dhe qëllimi auditimit

Objekti i auditimit është vlerësimi i përdorimit dhe menaxhimit të burimeve të teknologjisë së informacionit nga Ministria e Arsimit, me fokus tek ekzistenca dhe efektiviteti i kontrolleve kryesore për mbrojtjen e të dhënave. Auditimi ka pasur për qëllim të përcaktojë nëse praktikat e ndjekura janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të MA dhe standardet e sigurisë së informacionit, si dhe nëse sigurohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit.
Qëllimi i auditimit të kryer në Ministrinë e Arsimit është të ofrojë një vlerësim të pavarur mbi gjendjen aktuale të kontrolleve të teknologjisë së informacionit, në raport me menaxhimin, sigurinë, mirëmbajtjen dhe përdorimin e infrastrukturës ekzistuese. Auditimi synon të identifikojë dobësitë dhe proceset teknologjike, të vlerësojë rreziqet e mundshme. Për realizimin e këtij qëllimi, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna, dokumente, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310.

II.2 Identifikimi i çështjeve

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr. 1210/1, datë 12.03.2026.
1.Auditimi i Qeverisjes dhe sigurisë së informacionit
2.Auditimi i Sistemeve

II.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Ministria e Arsimit është institucioni përgjegjës për drejtimin e politikave shtetërore në fushat e arsimit dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Në krye të institucionit qëndron Ministri, i cili mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e të gjithë veprimtarisë së Ministrisë dhe institucioneve në varësi të saj, duke ushtruar kompetenca që rrjedhin nga Kushtetuta dhe ligjet specifike për arsimin e lartë dhe atë para universitar. Për realizimin e misionit politik, Ministri

asistohet nga Zëvendësministri dhe Kabineti, i cili funksionon si organ këshillimor me funksionarë politikë. Veprimtaria administrative dhe teknike e Ministrisë organizohet përmes drejtorive të përgjithshme dhe drejtorive specifike, ku personeli ndahet në funksionarë politikë dhe nëpunës civilë, këta të fundit të përzgjedhur sipas procedurave të ligjit "Për nëpunësin civil".
Ministria menaxhon proceset arsimore përmes një ndarjeje funksionale:

- Përmes drejtorive përkatëse, MA harton politikat dhe strategjitë e zhvillimit, monitoron performancën e arsimit dhe garanton zbatimin e parimeve të gjithë përfshirjes, me fokus të veçantë te nxënësit e minoriteteve në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.
- Institucioni përgjigjet për hartimin e politikave të programeve të studimit dhe administrimin e kërkimit shkencor, duke u mbështetur në mbledhjen e të dhënave të detajuara dhe analizat statistikore.
- Ministria siguron harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian dhe koordinon detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), përfshirë menaxhimin e projekteve IPA.
- Një aspekt i rëndësishëm i funksionit rregullator është dhënia e lejeve në arsimin e lartë dhe licencave në atë para universitar, si dhe monitorimi i standardeve të shërbimeve që ofrohen nga subjektet përkatëse.

II.4 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Ministrinë e Arsimit mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri në 31.12.2025, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.
Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 1210/1, datë 12.03.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon Ministria e Arsimit. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

II.5 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë Raport Përfundimtar krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.
Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Standardedet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT, ISO/IEC 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji Nr. 43/2023 "*Për Qeverisjen Elektronike*";
- Ligji Nr. 25/2024, "Për Sigurinë Kibernetike";

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 124/2024 për mbrojtjen e të dhënave personale;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë eSektorit Publik", i ndryshuar;
- Rregullore e Brendshme – Ministria e Arsimit
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.6 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310.

II.7 Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Ministrinë e Arsimit janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi.

II.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ministria e Arsimit është autoriteti më i lartë ekzekutiv i menaxhimit të arsimit para universitar, e cila ka për mision zbatimin e politikave kombëtare arsimore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë qytetarët shqiptarë. MA harton dhe ndjek zbatimin e strategjive kombëtare arsimore, bazës ligjore për arsimin, nxjerrja e akteve nënligjore, planifikon buxhetin, si dhe bashkëpunon me njësitë themelore të qeverisjes lokale si edhe përcakton standardet e kurrikulës, administrative dhe infrastrukturore dhe harton politikat e zhvillimit profesional.
Në ushtrimin e veprimtarisë së saj MA ka si mision:

- Sigurimin e një arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Evropiane për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësim nxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

- Vlerësim të cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent monitorimi, në planifikimin dhe përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim.
- Arsim cilësor e gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Evropiane: ndërtime të reja, përshtatje të godinave ekzistuese shkollore për përfshirjen e fëmijëve me AK, rehabilitim të objekteve arsimore
- Hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së re në arsimin e mesëm. Mbështetja e zhvillimit profesional të mësuesve. Promovimi dhe zgjerimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në edukim. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore në institucionet shkollore të arsimit të mesëm.

Ministria e Arsimit nuk administron në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur nga strukturat e saj të brendshme, asnjë sistem të teknologjisë së informacionit.
Sistemet e teknologjisë së informacionit që janë në përdorim në linjën e Ministrisë së Arsimit administrohen plotësisht, nga ana teknike, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe janë ngritur pranë njësive shpenzuese vartëse të Ministrisë, të cilat janë njëkohësisht edhe përfituese të këtyre shërbimeve TIK. Ministria nuk disponon evidenca apo dokumentacion teknik mbi kontrollin dhe operimin e sistemeve që janë ngritur pranë njësive vartëse. si dhe nuk zotëron infrastrukturë TIK në inventarët e saj, si server, baza të dhënash apo sisteme aplikative, për shkak se kjo infrastrukturë është e centralizuar dhe administrohet nga AKSHI. Po kështu Ministria e Arsimit nuk administron drejtpërdrejt sisteme apo baza të dhënash shtetërore, pasi sipas ligjit nr.43/23 datë 13.06.2023, Për qeverisjen elektronike, ato janë pjesë e infrastrukturës së qeverisjes elektronike dhe administrohen teknikisht nga AKSHI.


2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1Auditimi i funksionimit të Qeverisjes dhe Sigurisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 1 "*Auditimi i Qeverisjes dhe Sigurisë së Informacionit*" të Programit të Auditimit nr. 1210/1, datë 11.03.2026 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
- Regjistër risku si dhe planet e menaxhimit të tij për periudhën e audituar;
- Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Përshkrim i përgjithshëm i teknologjisë së informacionit në MA;
- Etj.

Burimet Njerëzore
Struktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), e atashuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe në varësi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), funksionon me një organikë të përbërë nga një drejtues dhe katër specialistë, nga të cilët një pozicion rezulton vakant.



Drejtoria TIK ka në përgjegjësi drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve që lidhen me funksionimin e sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, përfshirë implementimin e projekteve TIK, analizën e sistemeve ekzistuese, si dhe sigurimin e respektimit të standardeve të sigurisë dhe konfidencialitetit të informacionit.
Specialistët TIK pranë Ministrisë dhe institucioneve të varësisë kryejnë funksione operacionale dhe teknike, të cilat përfshijnë mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe rrjeteve, administrimin e sistemeve operative dhe shërbimeve të postës elektronike, ofrimin e asistencës teknike për përdoruesit, si dhe mbështetjen e sistemeve qeveritare dhe shërbimeve dixhitale në përdorim.

Politikat aktet rregullatorë të standardeve në TIK

Strategjia e Teknologjisë së Informacionit përbën lidhjen e përbashkët midis objektivave të zhvillimit të TI-së dhe objektivave strategjikë të institucionit. Ajo duhet të mbështetet në nevojat aktuale dhe të ardhshme të institucionit, në kapacitetet ekzistuese të TI-së për ofrimin e shërbimeve, si dhe në kërkesat për burime njerëzore, financiare dhe teknologjike. Në këtë kuadër, strategjia duhet të marrë në konsideratë infrastrukturën dhe arkitekturën ekzistuese të TI-së, modelin e ofrimit të shërbimeve, investimet e nevojshme dhe strukturën e stafit, duke i integruar të gjitha këto elemente në një qasje të unifikuar dhe të orientuar drejt mbështetjes së objektivave të institucionit. Po aq e rëndësishme është edhe ekzistenca e një strategjie të TI-së të miratuar për institucionin, e cila të përcaktojë qartë fushëveprimin, prioritetet dhe mënyrën e zbatimit, si dhe të sigurojë që qeverisja e TI-së të jetë pjesë e procesit të vendimmarrjes dhe monitorimit institucional.
Nga analizimi i Agjendës Dixhitale të Shqipërisë 2022–2026 u konstatua se Ministria e Arsimit është ngarkuar me zbatimin e disa ndërhyrjeve konkrete për sektorin arsimor, përfshirë përmirësimin e sistemit të menaxhimit të informacionit të arsimit të lartë, lidhjen e institucioneve arsimore me GovNet dhe zbatimin e strategjisë për aftësitë dixhitale, si dhe masa të tjera që lidhen me integrimin e TIK-ut në kurrikulë, trajnimin e mësuesve dhe zhvillimin e laboratorëve smart. Nga auditimi i dokumentacionit nuk rezultoi një plan veprimi i detajuar, me afate, përgjegjësi, burime dhe tregues të matshëm performance, që të mundësonte monitorimin sistematik të zbatimit të këtyre masave.
Një nga dokumentet kryesore që rregullon organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Arsimit është Rregullorja e Brendshme e institucionit e miratuar me Urdhrin nr. 58, datë 05.02.2025, e cila përcakton strukturat organizative, përgjegjësitë dhe detyrat funksionale të njësive përbërëse të saj. Kjo rregullore shërben si dokument bazë për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe mbështetëse, përfshirë edhe aspektet që lidhen me përdorimin e teknologjisë së informacionit.
Nga shqyrtimi i kësaj rregulloreje rezulton se ajo është hartuar në një periudhë kur funksionet e teknologjisë së informacionit trajtoheshin si pjesë e strukturave të brendshme të institucionit, duke i përfshirë këto funksione në varësi të drejtorive administrative dhe mbështetëse.
Nga auditimi u konstatua se rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit nuk është përditësuar plotësisht në përputhje me ndryshimet e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e teknologjisë së informacionit, në veçanti me modelin e centralizuar të administrimit të sistemeve TIK sipas VKM nr. 673/2017 (i ndryshuar) dhe kërkesave të ligjit nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”.
Në këtë kuadër, rregullorja vijon të parashikojë funksione dhe përgjegjësi të lidhura me teknologjinë e informacionit si pjesë të strukturës së brendshme të institucionit, pa reflektuar kalimin e këtyre funksioneve në nivel qendror pranë AKSHI-t dhe pa përcaktuar mekanizma të qartë bashkëpunimi, koordinimi dhe mbikëqyrjeje ndaj këtij institucioni.

Institucionet në varësi të Ministrisë së Arsimit janë:

- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);
- Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA);
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL);
- Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL);
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP);
- Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP);
- Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD).

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se Ministria e Arsimit nuk ka kërkuar dhe administruar në mënyrë periodike raporte nga Institucionet e varësisë (Institucionet që administrojnë sisteme) lidhur me veprimtarinë e sistemeve informatike që këto struktura administrojnë, përfshirë performancën, disponueshmërinë, incidentet teknike, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe realizimin e objektivave përkatëse. Mungesa e kërkesës dhe administrimit të këtyre raporteve kufizon monitorimin institucional, vlerësimin e eficiencës së sistemeve dhe marrjen e vendimeve të mbështetura në informacion të plotë mbi funksionimin e tyre.

Administrimi i shërbimeve IT të ofruara nga AKSHI

Referuar Ligji Nr.43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike", funksionet dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit të atashuara pranë ministrive dhe institucioneve të administratës shtetërore ofrohen nëpërmjet strukturave përgjegjëse të AKSHI-t. Në këtë kuadër, marrëdhënia funksionale ndërmjet Ministrisë dhe AKSHI-t kërkon përcaktim të qartë të mënyrës së ofrimit të shërbimeve, përgjegjësive përkatëse dhe standardeve të performancës. Nga auditimi u konstatua se marrëdhënia operacionale ndërmjet institucionit dhe AKSHI-t nuk është formalizuar nëpërmjet marrëveshjeve të dokumentuara të nivelit të shërbimit (SLA), në të cilat të përcaktohen qartë shërbimet që ofrohen, rolet dhe përgjegjësitë e palëve, afatet e reagimit dhe rikuperimit, standardet e disponueshmërisë, si dhe treguesit për matjen e performancës. Mungesa e një kuadri të tillë formal krijon paqartësi në administrimin e përgjegjësive, vështirëson monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, kufizon mundësinë e mbajtjes së përgjegjësisë në rast ndërprerjesh apo problematikash teknike dhe rrit riskun e mosrealizimit të pritshmërive operacionale.

Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK

Monitorimi dhe kontrolli i riskut përbën një proces të vazhdueshëm të identifikimit, analizimit, vlerësimit dhe trajtimit të rreziqeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Ky proces përfshin evidentimin e risqeve të reja, rishikimin periodik të risqeve të identifikuara më parë, si dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të planifikuara për minimizimin e tyre. Menaxhimi i riskut në fushën e teknologjisë së informacionit konsiston në zbatimin e metodologjive të menaxhimit të riskut ndaj sistemeve, proceseve dhe burimeve teknologjike, me qëllim administrimin e rreziqeve që lidhen me përdorimin, administrimin, sigurinë, zhvillimin dhe varësinë nga teknologjia e informacionit në Ministrinë e Arsimit. Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit nuk disponon një regjistër risku të konsoliduar, në të cilin të përfshihen edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit, si dhe nuk u paraqitën evidenca mbi identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin periodik të këtyre risqeve gjatë periudhës së audituar. Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, njësitë publike kanë detyrimin të identifikojnë, vlerësojnë dhe dokumentojnë risqet që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave institucionale. Në këtë kuadër, mungesa e përfshirjes së risqeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e menaxhimit të riskut tregon mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm, duke rritur ekspozimin e institucionit ndaj incidenteve teknologjike, ndërprerjes së shërbimeve, cenimit të sigurisë së informacionit dhe përdorimit joefektiv të burimeve publike.

Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Siguria e informacionit është e rëndësishme për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Auditimi i sigurisë së informacionit identifikon sfidat dhe rreziqet e mundshme në nivelin e sigurisë së informacionit dhe ndihmon në zhvillimin e strategjive për t'i përballuar ato. Në të njëjtën kohë, ai identifikon politikat dhe procedurat e sigurisë së informacionit dhe vlerëson se a janë ato të përshtatshme dhe të ndjekura me përpikëri nga punonjësit e Institucionit.

Rrjeti informatik i institucionit përbëhet nga infrastruktura e komunikimit të të dhënave, telefonisë, sigurisë dhe serverëve, të vendosura në sallën e serverave. Pajisjet kryesore të rrjetit janë të instaluara në rack 42 HU dhe përfshijnë patch panel-e, switch-e Gigabit 24 porta, patch korda Cat 6 dhe pajisje ndihmëse për organizimin e kabllimeve. Sistemi i sigurisë përfshin kamera IP të brendshme dhe të jashtme të lidhura me NVR, monitorë vëzhgimi dhe software administrimi. Gjithashtu janë instaluar sistemi i alarmit kundër ndërhyrjeve, sistemi i kontrollit të aksesit me karta dhe centrali i zjarrit i adresueshëm.

Infrastruktura e serverëve përbëhet nga dy Dell PowerEdge , një storage Dell EMC PowerVault dhe firewall Sophos për mbrojtjen e rrjetit. Furnizimi me energji rezervë realizohet nga 2 UPS. Nga verifikimi i pajisjeve IT të Ministrisë rezulton se disa prej tyre kanë përfunduar ciklin e jetës (EOL), konkretisht serveri *Dell EMC PowerEdge R640*, storage *Dell EMC PowerVault ME4024* dhe pajisja e sigurisë *Sophos XG430*. Këto pajisje paraqesin risk për vazhdimësinë e shërbimeve dhe sigurinë, për shkak të mundësisë së mungesës së mbështetjes teknike, përditësimeve dhe pjesëve rezervë. Në lidhje me rrjetin e brendshëm nga auditimi u konstatua se: Institucioni nuk disponon dokumentacion zyrtar, të miratuar dhe të përditësuar që përshkruan arkitekturën e rrjetit, topologjinë, pajisjet dhe konfigurimet bazë, në kundërshtim me kërkesat e ISO/IEC 27001:2022.

Nga analizimi në anën teknike të Platformës zyrtare elektronike e institucionit (https://arsimi.gov.al) u evidentua që ajo funksionon nëpërmjet një infrastrukture ndërmjetëse të administruar nga palë të treta, jashtë Republikës së Shqipërisë e cila përdoret njëkohësisht edhe nga disa faqe të tjera të sektorit publik. Kjo arkitekturë ofron menaxhim të centralizuar të trafikut dhe mekanizma mbrojtës, por njëkohësisht krijon varësi operacionale nga shërbime të përbashkëta të jashtme. Çdo mosfunksionim teknik, gabim konfigurimi, ndërprerje shërbimi apo incident kibernetik që prek këtë infrastrukturë të përbashkët mund të ndikojë drejtpërdrejt në disponueshmërinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve online të institucionit.

Përdorimi i një infrastrukture të përbashkët në nivel perimetri mund të kufizojë kontrollin e drejtpërdrejtë të institucionit mbi disa konfigurime sigurie, kohën e reagimit dhe rikuperimin e shërbimeve, veçanërisht në rastet kur përgjegjësitë ndahen ndërmjet administratorëve të brendshëm dhe ofruesve të jashtëm. Në mungesë të vlerësimeve periodike të riskut, planeve të vazhdimësisë së biznesit dhe marrëveshjeve të qarta për nivelin e shërbimit, institucioni mund të hasë vështirësi në garantimin e aksesit të pandërprerë në shërbimet dixhitale dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë operacionale.

Për pasojë, problematikat ose ndërprerjet që prekin mjedisin e përbashkët mund të cenojnë ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, të ulin besimin ndaj shërbimeve elektronike dhe të ekspozojnë institucionin ndaj riskut operacional.

Auditi i Brendshëm

Misioni i njësisë së auditimit të brendshëm, si pjesë e strukturës e Ministrisë së Arsimit është orientimi i veprimtarisë, në mënyrë të pavarur duke dhënë garanci të arsyeshme, për eficencën, efektivitetin, ekonomicitetin e menaxhimit të burimeve, përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut. Ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe

forcimin e kapaciteteve profesionale të auditimit. Auditi i brendshëm në Ministrisë së Arsimit është e organizuar në nivel Drejtorie e përbërë nga një Drejtor dhe katër specialistë.
Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditit të Brendshëm në MA për periudhën 01.01.2024-31.12.2025 nuk ka kryer asnjë auditim ose ka përfshirë në auditim çështje të teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik". "Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm. Veprimtaria e auditit të brendshëm në sektorin publik duhet të kryhet në përputhje me:
-Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuara për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;
-Këtë ligj dhe të gjitha aktet nënligjore bazuar në këtë ligj;
-Kryerjen e auditimeve të Teknologjisë së Informacionit sipas përcaktimeve te nenit 4, Pika 6, nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4449/1 prot., datë 03.07.2026 "Komente dhe shpjegime në lidhje me projekt-raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit,, me objekt "Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me gjetjen 1 të e paraqitur në raportin e auditimit, sqarojmë se, për komponentët që lidhen me integrimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në kurrikul dhe zhvillimin profesional të mësuesve janë ndërmarrë masa konkrete, të mbështetura në dokumente planifikimi që përcaktojnë veprimtaritë, afatet, institucionet përgjegjëse dhe produktet e pritshme.
Në këtë kuadër, me Urdhrin nr. 610, datë 20.12.2024, "Për miratimin e Kornizës Kurrikulare dhe planin e veprimtarive për rishikimin dhe përditësimin e paketës kurrikulare të arsimit parauniversitar", është hartuar plani i veprimtarive, duke përcaktuar procesin e rishikimit dhe përditësimit të të gjithë kurrikulës, përfshirë edhe hartimin e programeve të reja të TIK për klasat 1-12. Plani parashikon veprimtaritë, afatet e realizimit, institucionet përgjegjëse dhe produktet që duhet të hartohen në secilën fazë.
Në zbatim të tij ka nisur procesi i hartimit dhe përditësimit të programeve të TIK-ut me synim forcimin e kompetencave digjital, të menduarit kompjuterik, kodimit, përdorimit të sigurt të teknologjisë dhe integrimit të inteligjencës artificiale në procesin mësimor.....

***

Në lidhje me gjetjen 3 sqarojmë se se, Ministria e Arsimit nuk administron në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur asnjë sistem të teknologjisë së informacionit. Sistemet e teknologjisë së informacionit që përdoren në linjën e Ministrisë së Arsimit administrohen plotësisht nga pikëpamja teknike, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Këto sisteme janë ngritur pranë njësive shpenzuese vartëse të Ministrisë, të cilat janë njëkohësisht përfituese të shërbimeve TIK. Ministria nuk zotëron infrastrukturë TIK në inventarin e saj (si serverë, databaza apo sisteme aplikative), për shkak se kjo infrastrukturë është e centralizuar dhe administrohet nga AKSHI.

****

Në lidhje me gjetjen 4 sqarojmë se Sqarojmë se, Ministria e Arsimit ka ngritur dhe zbaton mekanizma të menaxhimit të riskut në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve kryhet në funksion të objektivave institucionale dhe në përputhje me përgjegjësitë funksionale të çdo strukture.

***

Në lidhje me gjetjen nr.5 ju sqaroj se: Organizimi i angazhimeve të auditimit të brendshëm, hartimi dhe zbatimi i planit strategjik e vjetor, përgatitja e raportit vjetor, të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për periudhat respektive, janë kryer sipas përcaktimeve të nenit 14, të Ligjit për Auditimin e Brendshëm, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë burimet e auditimit dhe kompetencat e audituesve të brendshëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me gjetjen nr. 1, pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë, pasi nuk është shoqëruar me dokumentacion shtesë që të ndryshojë konstatimin e auditimit.

Në lidhje me gjetjen nr. 3, pretendimi i subjektit nuk ndryshon konstatimin e auditimit. Edhe pse administrimi teknik i sistemeve TIK kryhet nga AKSHI, Ministria mbetet pronare funksionale e proceseve që mbështeten nga këto sisteme dhe ka përgjegjësi për qeverisjen, monitorimin, identifikimin e risqeve dhe sigurimin e funksionimit efektiv të tyre, në përputhje me kompetencat institucionale.

Në lidhje me gjetjen nr. 4, pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë, pasi gjatë auditimit nuk u administruan evidenca të mjaftueshme që të dokumentonin identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve të lidhura me teknologjinë e informacionit. Referimi në kuadrin ligjor nuk përbën provë të zbatimit efektiv të proceseve të menaxhimit të riskut në fushën TIK.

Në lidhje me gjetjen nr.5, pretendimi i subjektit nuk merret në konsideratë, pasi auditimi nuk ka vënë në diskutim respektimin formal të dispozitave ligjore për organizimin e auditimit të brendshëm, por mungesën e angazhimeve të auditimit të orientuara drejt sistemeve dhe kontrolleve të teknologjisë së informacionit.MA nuk paraqiti evidenca që provojnë realizimin e auditimeve të tilla gjatë periudhës objekt auditimi.

2.2 Auditimi i Sistemeve

Gjatë auditimit në terren, grupi i auditimit zhvilloi intervista dhe administroi pyetësorë pranë Ministrisë së Arsimit, lidhur me sistemet e teknologjisë së informacionit (TI) që përdoren në institucion. Përmes shkresës nr. 3084/2, datë 28.04.2026, Ministria sqaroi se nuk administron sisteme informacioni dhe nuk ushtron funksione teknike për menaxhimin, mirëmbajtjen apo kontrollin administrativ të tyre. Nga verifikimet e kryera rezultoi se institucioni nuk disponon dokumentacion teknik, evidenca administrative apo akses operacional mbi kontrollin dhe funksionimin e sistemeve të ngritura pranë njësive vartëse. Në zbatim të ligjit nr. 43/2023, datë 13.06.2023 "Për qeverisjen elektronike", këto sisteme janë pjesë e infrastrukturës së qeverisjes elektronike dhe administrohen teknikisht nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Për rrjedhojë, vlerësimi dhe testimet e drejtpërdrejta mbi këto sisteme nuk u përfshinë në objektin e këtij auditimi, pasi administrimi i tyre teknik dhe operacional nuk është kompetencë e Ministrisë së Arsimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, megjithëse Ministria e Arsimit është përcaktuar në Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022–2026 si institucion përgjegjës për zbatimin e një sërë masash në fushën e digjitalizimit të arsimit, nuk disponohet një plan veprimi i detajuar dhe i dokumentuar që të përcaktojë objektivat konkretë, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, burimet e nevojshme dhe indikatorët e matshëm të performancës për monitorimin e progresit të këtyre masave. Në mungesë të këtij planifikimi operacional, kufizohet mundësia për ndjekjen sistematike të zbatimit të objektivave strategjikë, vlerësimin e rezultateve dhe evidentimin në kohë të problematikave apo vonesave në realizimin e tyre, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të auditimit të Teknologjisë së Informacionit (COBIT).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të AKSHI-t për teknologjinë e informacionit, të marrë masat për hartimin dhe miratimin e një plani veprimi të detajuar për zbatimin e masave të parashikuara në Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022–2026, duke përcaktuar qartë afatet kohore, përgjegjësitë institucionale, burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme, si dhe tregues të matshëm të performancës për monitorimin periodik dhe vlerësimin e realizimit të tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit nuk është përditësuar plotësisht në përputhje me ndryshimet e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e teknologjisë së informacionit, në veçanti me modelin e centralizuar të administrimit të sistemeve TIK sipas Vendimi nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar dhe kërkesave të ligjit nr. 43/2023 *"Për qeverisjen elektronike"*.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit të marrë masat për rishikimin dhe përditësimin e "Rregullores së Brendshme", me qëllim reflektimin e qartë të ndarjes aktuale të përgjegjësive ndërmjet Ministrisë dhe AKSHI-t, si dhe përcaktimin e mekanizmave të bashkëpunimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes në fushën e teknologjisë së informacionit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit teknik rezultoi se Ministria e Arsimit nuk ka kërkuar dhe administruar në mënyrë periodike raporte nga institucionet e varësisë (institucionet që administrojnë sisteme) lidhur me veprimtarinë e sistemeve informatike që këto struktura administrojnë, përfshirë performancën, disponueshmërinë, incidentet teknike, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe realizimin e objektivave përkatëse. Mungesa e kërkesës dhe administrimit të këtyre raporteve kufizon monitorimin institucional, vlerësimin e eficiencës së sistemeve dhe marrjen e vendimeve të mbështetura në informacion të plotë mbi funksionimin e tyre. Kjo praktikë vjen në mospërputhje me praktikat e mira të qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit dhe kërkesat e kuadrit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut në sektorin publik (përfshirë parimet e COBIT).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit të marrë masa duke vendosur një mekanizëm të rregullt raportimi nga institucionet e varësisë për sistemet që ato administrojnë, ku të kërkohen raporte periodike mbi performancën, disponueshmërinë, incidentet teknike, mirëmbajtjen dhe realizimin e objektivave, si dhe të krijojë një proces të qartë për analizimin dhe ndjekjen e këtyre raporteve.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se marrëdhënia operacionale ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe AKSHI-t nuk është formalizuar nëpërmjet marrëveshjeve të dokumentuara të nivelit të shërbimit (SLA), në të cilat të përcaktohen qartë shërbimet që ofrohen, rolet dhe përgjegjësitë e palëve, afatet e reagimit dhe rikuperimit, standardet e disponueshmërisë, si dhe treguesit për matjen e performancës. Mungesa e një kuadri të tillë formal krijon paqartësi në administrimin e përgjegjësive, vështirëson monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara, kufizon mundësinë e mbajtjes së përgjegjësisë në rast ndërprerjesh apo problematikash teknike dhe rrit riskun e mosrealizimit të pritshmërive operacionale. Kjo situatë është në kundërshtim me praktikat më të mira të qeverisjes TI.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për formalizimin e marrëdhënieve operacionale dhe teknike përmes marrëveshjeve të nivel

shërbimit ose dokumente ekuivalente, ku të përcaktohen qartë përgjegjësitë e palëve, nivelet e shërbimit, afatet e reagimit, procedurat e menaxhimit të incidenteve, si dhe mekanizmat e monitorimit të performancës të sistemeve dhe shërbimeve elektronike.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit nuk disponon një regjistër risku të konsoliduar, në të cilin të përfshihen edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit, si dhe nuk u paraqitën evidenca mbi identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin periodik të këtyre risqeve gjatë periudhës së audituar. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, njësitë publike kanë detyrimin të identifikojnë, vlerësojnë dhe dokumentojnë risqet që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave institucionale. Në këtë kuadër, mungesa e përfshirjes së risqeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e menaxhimit të riskut tregon mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm, duke rritur ekspozimin e institucionit ndaj incidenteve teknologjike, ndërprerjes së shërbimeve, cenimit të sigurisë së informacionit dhe përdorimit joefektiv të burimeve publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Struktura përgjegjëse për menaxhimin e riskut dhe kontrollin e brendshëm në Ministrinë e Arsimit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për teknologjinë e informacionit të marrin masa për hartimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të riskut për teknologjinë e informacionit, duke siguruar që risqet e Teknologjisë së informacionit të integrohen në sistemin e menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit nuk disponon dokumentacion zyrtar, të miratuar dhe të përditësuar për arkitekturën e rrjetit të brendshëm, i cili të përshkruajë topologjinë e rrjetit, pajisjet, lidhjet, segmentimin dhe konfigurimet bazë, në kundërshtim me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022. Mungesa e këtij dokumentacioni kufizon mundësinë për administrimin efektiv, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës së rrjetit

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me Drejtorinë e TI-së të atashuar nga AKSHI, të marrë masat e për hartimin, miratimin dhe përditësimin periodik të dokumentacionit zyrtar të arkitekturës së rrjetit të brendshëm, duke përfshirë topologjinë e rrjetit, pajisjet, lidhjet, segmentimin dhe konfigurimet bazë, me qëllim sigurimin e një pasqyre të plotë dhe të përditësuar të infrastrukturës, si dhe mbështetjen e administrimit teknik dhe sigurisë së saj.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit të Ministrisë së Arsimit rezultoi se disa prej tyre kanë përfunduar ciklin e jetës (EOL), konkretisht serveri Dell EMC PowerEdge R640*, storage* Dell EMC PowerVault ME4024 dhe pajisja e sigurisë Sophos XG430. Këto pajisje paraqesin risk për vazhdimësinë e shërbimeve dhe sigurinë, për shkak të mundësisë së mungesës së mbështetjes teknike. Kjo situatë është në kundërshtim me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022 për menaxhimin e aseteve teknologjike dhe me praktikat e mira të qeverisjes së TI-së.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e TI-së të atashuar nga AKSHI, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një plani për modernizimin e pajisjeve që kanë arritur fundin e ciklit të jetës, duke përcaktuar prioritetet, buxhetin dhe afatet për zëvendësimin e serverëve, sistemeve të ruajtjes së të dhënave (storage)

dhe pajisjeve të sigurisë, me qëllim minimizimin e riskut për vazhdimësinë e shërbimeve dhe sigurinë e infrastrukturës së TI-së.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi në anën teknike të platformës zyrtare elektronike e institucionit (https://arsimi.gov.al) u evidentua që ajo funksionon nëpërmjet një infrastrukture ndërmjetëse të administruar nga palë të treta, jashtë Republikës së Shqipërisë e cila përdoret njëkohësisht edhe nga disa faqe të tjera të sektorit publik. Kjo arkitekturë ofron menaxhim të centralizuar të trafikut dhe mekanizma mbrojtës, por njëkohësisht krijon varësi operacionale nga shërbime të përbashkëta të jashtme. Në mungesë të një vlerësimi të dokumentuar të rreziqeve dhe të dokumentacionit mbi mekanizmat e sigurisë, vazhdimësisë së shërbimit dhe rikuperimit nga ofruesi i shërbimit, çdo mosfunksionim teknik, gabim konfigurimi, ndërprerje shërbimi ose incident kibernetik që prek këtë infrastrukturë mund të ndikojë në disponueshmërinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve elektronike të institucionit, në kundërshtim me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masat për vlerësimin e rreziqeve që lidhen me përdorimin e infrastrukturës së ndërmjetme të administruar nga palë të treta, si dhe të sigurojë dokumentacionin përkatës mbi mekanizmat e sigurisë, vazhdimësisë së shërbimit dhe rikuperimit nga incidentet, si dhe të përcaktojë dhe zbatojë masa kontrolli për reduktimin e varësisë operacionale dhe rritjen e disponueshmërisë e qëndrueshmërisë së shërbimeve online.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025, nuk ka planifikuar dhe nuk ka kryer auditime në fushën e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenet 8 dhe 14 të Ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik". Mungesa e auditimeve të TI-së kufizon vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve të përgjithshme dhe specifike të teknologjisë së informacionit, si dhe mundësinë për identifikimin dhe adresimin në kohë të dobësive që lidhen me sigurinë e informacionit, administrimin e sistemeve, menaxhimin e rreziqeve dhe vazhdimësinë e shërbimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brendshëm të marrë masa mbi planifikimin dhe kryerjen e auditimeve mbi teknologjinë e informacionit, me qëllim vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e TI-së, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive mbi arritjen e objektivave të institucionit.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT